

---

# **Deutsche Welle**

## **Interviste per 'Largimin e Trurit'**

<http://www.dw-world.de>

Londër, 13 May 2004

Intervistoi **Vilma Filaj-Ballvora**

---

**Deutsche Welle:** Ç'eshte 'brain drain' dhe qe kur njihet ky fenomen ne shoqeri?

**Dr Gëzim Al pion:** Fenomeni 'brain drain' mund te duket nje zhvillim i ri per ne Evropiano-Lindoret. Megjithate, sic e theksova ne seminarin per emigracionin qe u organizua ne Prill ne Dortmund nga shoqata Gjermani-Shqiperi, ky fenomen eshte po aq i vjeter sa edhe shoqeria njerzore. Njerezit e edukuar e ambicioze gjithmone e kane lene vendin e lindjes. Arsytet per kete jane nga me te ndryshmet: perndjekjet politike, zemerngushtesia e elites politike, kulturore e shkencore per te mundesuar progresin e karrieres te individeve te talentuar, dhe sigurisht deshira per te pasur nje jetese me te mire.

Me perjashim te Hungarise dhe Polonise, ne pergjithesi brain drain-i nuk ishte problem shqetesues per Evropen Lindore gjate gjysmes se dyte te shekullit te 20-te. Me permbysjen e socializmit ne fund te viteve 80-te, dhe vacenerisht gjate viteve 90-te, brain drain-i u be nje fenomen shume serioz sepse nje pjese e konsiderueshme e emigranteve qe u turren drejt Perendimit perbehej nga intelektuale, artiste dhe shkencetare. E verteta eshte se asnje vend i rajonit nuk u perjashtua nga ky eksod i trurit, por ne disa vende ky eksod ishte me permasa me te medha. Nder keto vende jane Rumania, Bullgaria, Polonia dhe vecanerisht Shqiperia.

Me perjashtim te periudhes 1945-1989, per ne shqiptaret bain drain-i ka qene nje dukuri me se e zakonshme. Qe nga pushtimi Romak dhe deri ne fillim te shekullit te 20-te kur Perandoria Turke pushoi se ekzistuari, shqiptaret e kishin per tradite te largoheshin nga trojet e tyre per te bere karriere ne Rome apo Stamboll. Po te aplikojme diskursin qe perdorim sot per te pershkruar disa personalitete te shquara nga Shqiperia ose me origjine shqiptare, te atyre koherave, ata nuk jane gje tjeter vecse shembuj te hershem te emigrimit te trurit shqiptar per ne metropolet e huaja. Nga rradhet e ketyre emigranteve shqiptare mendohet te kene dalur nje numer i konsiderueshem Perandoresh Romake dhe personalitetesh te shquara te Vatikanit, disa kryeministra te Turqise, si dhe disa arkitekthe te paimitueshem qe ndertuan kryevepra arkitekturale ne Evrope, Azi, dhe Afrike. Emigrimi i sotem i trurit shqiptar eshte nje kapitull i ri e nje historie te vjeter.

**Deutsche Welle:** A eshte 'brain drain' nje dukuri vetem me efekt negativ per shoqerite e prekura?

**Dr Gëzim Alpion:** Ne veshtrim te pare duket se largimi i trurit eshte nje fenomen me pasoja shume te renda per vendet e prekura nga ky fenomen, dhe deri diku kjo edhte e vertete. Nga eksodi i trurit goditen rende ekonomia, arti, shkenca, arsimi dhe jeta politike. Nga studimet e kryera ne 10 vjetet e fundit ne Evropen Lindore del se shume te diplomuar si pedagoge, mjeke, artiste, e shkencetare jane larguar, shumica pergjithmone, duke lene nje vakum te ndjeshem ne vendet e tyre te lindjes. Nje numer i madh spitalesh, universitetesh, dhe institucionesh kulturore dhe shkencore kane humbur ndoshta disa nga punonjesit me te afte nga eksodi i trurit. Dhe ky kontigjent nuk mund te zevendesohet menjehere.

Megjthate, une mendoj se brain drain-i nuk eshte vetem me efekt negativ per vendet nga largohen intelektualet.

**Deutsche Welle:** Cilat jane avantazhet per shoqerite e prekura?

**Dr Gëzim Alpion:** Avantazhi me i madh nuk eshte ne shumen e parave te cilet emigranet aktualisht po dergojne ne atdhe. Ky eshte nje perftim i rendesishem. Megjithate ky eshte nje perfitim emergjent qe nuk do te vazhdoje gjate sepse gradualisht emigrantet do ta rrallojne kontributin financiar per te afermit sepse te ardhurat qe

sigurojne ne Perendim u duhen per te arsimuar veten dhe femijet. Arsimimi eshte rruga kryesore nepermjet te cilit emigrantet do te mund te evitojne kryerjen e puneve te rendomta si punetore krahu ne Perendim per vete dhe per femijet e tyre.

Avantazhi me i madh tani per tani per vendet e prekura nga brain drain-i ka te beje me teper me kontributin qe intelektualet e emigruar po japin per te permisuar imazhin e vendeve te tyre. Fatkeqesisht, Evropa Lindore dhe vende si Rumani, Bullgaria, dhe vecanerisht Shqiperia, kane nje imazh shume te keq ne boten e zhvilluar. Me gjithë situaten e rende ekonomike ne Evropën Lindore, perceptimi i Perendimit per Shqiperine, Ballkanin dhe per Evropën Lindore ne pergjithese eshte me teper jo pasqyre e realitetit sesa nje tregues shqetesues i injorances dhe arrogances se Perendimit.

Intelektualet qe kane emigruar ne Perendim jane nje aset shume i rëndesishem per te mundesuar ndyshimin e imazhit negativ dhe deri diku racist qe Perendimi ka per vendet e Evropes Lindore dhe kryesisht per Shqiperine. Intelektualet e emigruar mund te jene shume me te efektshem se diplomatet Evropiano-Lindore ne Perendim per ta paraqitur kete pjese te Evropes si nje pjese vitale te kontinentit qe ka kulture te admirueshme, te lashte dhe bashkekohore, kulture dhe tradite qe duhet respektuar.

Intelektualet e emigruar kane mundesi te terheqin vemendjen e kolegeve perendimore dhe te institucioneve kulturore dhe shkencore ku jane punesuar ne Perendim per te kooperuar me institucione ne Evropën Lindore ne menyre qe te behen studime te perbashketa, investime dhe kembime eksperience.

Vecanerisht lektoret dhe punonjesit shkencore qe kane emigruar duhet te angazhohen per te dhene ndihmesen e tyre ne universitetet e vendeve nga jane larguar dhe kjo ndihmese mund te jete e formave te ndryshme, si vizita te shkurtera per te dhene cikle te caktuara leksionesh si dhe drejtimin e punimeve shkencore te studenteve nepermjet 'distant learning'. Shkenca ka mundesuar qe njerezit e kulturuar te ndodhen ne atdhe pa qene prezente atje fizikisht.

**Deutsche Welle:** Ne c'menyre shoqerite e prekura dukshem prej fenomenit te brain drain, si Shqiperia, do te mund ta shmangin ate?

**Dr Gëzim Alpion:** Fenomeni i brain drainit nuk mund të shmanget plotësisht. Dhe kjo është më se e vërtetë për Shqipërinë. Shqipëria është goditur jashtëzakonisht rëndë nga eksodi i trurit, dhe të dhënat tregojnë se ky fenomen vazhdon edhe sot të jetë me përmasa më të mëdha se në ndonjë vend tjetër në Evropën Lindore. Çdo vit mendohet se rreth 3000 studentë shqiptar largohen nga Shqipëria për të bërë studime kryesisht në Perëndim, gjë që do të thotë se vendi po humb çdo vit rreth një të tretën e kuadrove të ardhshme. Them se 'po humb' sepse shumica e tyre nuk kanë ndermend të kthehen në atdhe, të pakten jo menjëherë pas përfundimit të studimit.

Brain drain do të vazhdojë të jetë problem shqetësues për vendet e prekura nga ky fenomen për aq kohë sa gjendja politike dhe ekonomike nuk është e qëndrueshme. Në qoftë se shtetet perkatëse nuk bëjnë investimet e duhura në arsim, shkencë dhe kulturë, në qoftë se institucionet kërkimore shkencore dhe kulturore do të vazhdojë të jenë të politizuara, përderisa klikat politike do të vazhdojë të zhyten thellë e më thellë në korrupsion duke e asfiksuar ekonominë dhe jetën politike, kulturore dhe shkencore në vend, njëzëritë e arsimuar dhe ata që aspirojnë për arsim, shkencë, dhe kulturë do të vazhdojnë të largohen.

Disa politikane Evropiano Lindore, duke përfshirë edhe ca politikane shqiptare, u bëjnë thirrje bashkombesve të edukuar të kthehen në atdhe. Intelektualet nuk do të riatdheshohen me thirrje naivë dhe shpesh hipokrite nga politikane të korruptuar që vazhdojnë të pasurohen me metoda mafioze, por janë gjithmone doreshternguar kur vjen puna për të ritur rrogat e punonjësve të arsimit, mjeksisë, shkencës dhe kultures. Patriotizmi nuk imponohet. Shqiptarët nuk kanë nevojë për politikanet të mbajnë leksione për patriotizmin dhe atdhedashurinë. Njëzëritë kanë të drejtë të shkojnë ku të duan dhe të zhvillojnë karriere ku të krijohet mundësia.

Sigurisht që disa intelektuale të emigruar do të shkepusin lidhjet me atdheun, por pjesa dërmuese e emigranteve të arsimuar e kanë marrë Shqipërinë me vete në mërgim. Shumica e intelektualëve të suksesshëm shqiptar janë gjithmone të gatshëm të kontribuojnë në dobi të atdheut. Varet nga shteti shqiptar se sa do të jetë në gjendje të përfitojë nga një numër kaq i madh intelektualësh të cilët po i tregojnë Perëndimit se sa vital dhe me kulturë është kombi ynë.